

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**

**Pasqyrat financiare individuale  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

**(dhe Raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)**

## **Përbajtje**

Rapor i audituesve të pavarur.....	i-iii
Pasqyra individuale e pozicionit finançiar.....	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra individuale e flukseve monetare. ....	4
Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare.....	5 – 37
Raporte plotësuese.....	I-II

**Grant Thornton Sh.p.k.**  
Rr. Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D.,  
Shk. B, Floor 1, 10 000  
Tirana, Albania

T +355 44 525 880  
M +355 69 4014 701  
[www.grantthornton.al](http://www.grantthornton.al)

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Sigal Uniqa Group Austria sh.a,

### *Opinioni*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Sigal Uniqa Group Austria sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit finanziar më datë 31 dhjetor 2020, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të parasë për vitin që mbyllt në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat individuale financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin finanziar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllt në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkuar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njojur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvèç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvèç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në térësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojme gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i mosbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësish nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojme që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tonë janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të janë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduar në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazuë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- Marrim evidencë të mjaftueshme të auditimit të duhur në lidhje me informacionin financier të njësive ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Shoqërisë për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare individuale. Ne jemi përgjegjës për kryerjen e auditimit të Shoqërisë. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

#### *Raporte të tjera mbi Kërkasat e Kuadrit Rregullator*

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare Aktivet në Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit dhe Mjaftueshmërinë e Kapitalit, ("Anekse Shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkasat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare. Informacioni historik finansiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare, është në përputhje me informacionin vjetor finansiar shpalosur në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, përgatitur në përputhje me kërkasat e raportimit finansiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri  
26 prill 2021



**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra individuale e pozicionit finansiar**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)*

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>Aktive</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	9	84,633	84,588
Depozita me afat me bankat	10	4,456,883	3,847,055
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	11	442,362	572,177
Tatim fitimi i arkëtueshëm	29	-	30,177
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	12	349,946	336,853
Llogari të arkëtueshme nga risigurimi	13	1,155,633	2,073,544
Investime në filiale	14	2,223,050	2,223,050
Aktive afatgjata materiale	15	1,013,593	1,027,725
Aktive të tjera	16	257,847	160,187
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>9,983,947</b>	<b>10,355,356</b>
<b>Detyrime</b>			
Rezerva për dëme	17	2,914,708	3,745,478
Rezerva për primet e pafituar	18	2,176,935	2,193,911
Tatim fitimi i pagueshëm	29	74,161	-
Detyrime të tjera	19	732,347	783,554
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>5,898,151</b>	<b>6,722,943</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	20	2,232,909	2,232,909
Rezerva të rrezikut të sigurimit	21	262,225	262,225
Fitimi i mbartur		1,590,662	1,137,279
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>4,085,796</b>	<b>3,632,413</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>9,983,947</b>	<b>10,355,356</b>

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 20 mars 2021 dhe janë firmosur nga:

Avni Ponari  
Drejtore i përgjithshëm



Klement Mersini  
Drejtore Finance

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**

**Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Shënim	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Prime të shkruara bruto	22	3,890,395	4,293,007
Ndryshimi në rezervat e primeve të pafituar	18	16,976	(201,732)
Primet bruto te fituara		<b>3,907,372</b>	<b>4,091,275</b>
Prime të ceduara në risigurim	23	(599,152)	(677,803)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituar	18	(31,778)	111,464
<b>Të ardhura neto nga primi i sigurimit</b>		<b>(630,930)</b>	<b>(566,339)</b>
Të ardhura të tjera	24	71,198	60,275
<b>Të ardhura neto</b>		<b>3,347,640</b>	<b>3,585,211</b>
Ndryshimi në rezervat e dëmeve të sigurimit	17	830,770	(1,453,600)
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit ne rezervën e dëmeve	17	(886,133)	1,166,799
Dëme të paguara	17	(1,649,362)	(1,934,737)
Dëme të paguara të risiguruara	17	664,213	628,482
<b>Dëme të sigurimit neto</b>		<b>(1,040,512)</b>	<b>(1,593,056)</b>
Kostot e marrjes në sigurim	25	(646,619)	(681,589)
Shpenzime administrative	26	(936,783)	(991,238)
Shpenzime të tjera sigurimi	27	(184,443)	(263,882)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>539,283</b>	<b>55,447</b>
Të ardhura nga investimet	28	3,334	134,281
Fitim/(Humbje) nga kursi i këmbimit		<b>15,104</b>	<b>(25,845)</b>
		<b>18,438</b>	<b>108,436</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>557,721</b>	<b>163,883</b>
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	29	(104,338)	(31,529)
<b>Fitimi i vitiit</b>		<b>453,383</b>	<b>132,353</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitiit</b>		<b>453,383</b>	<b>132,353</b>

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital**  
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Kapitali akcionar	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Fitimi i mbartur	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2019</b>	<b>2,232,909</b>	<b>262,225</b>	<b>1,144,926</b>	<b>3,640,060</b>
Fitimi i vittit	-	-	132,353	132,353
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>132,353</b>	<b>132,353</b>
<b>Transaksione me pronarët e Shoqërisë</b>				
Dividendë të paguar	-	-	(140,000)	(140,000)
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(140,000)</b>	<b>(140,000)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>2,232,909</b>	<b>262,225</b>	<b>1,137,279</b>	<b>3,632,413</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>2,232,909</b>	<b>262,225</b>	<b>1,137,279</b>	<b>3,632,413</b>
Fitimi i vittit	-	-	453,383	453,383
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>453,383</b>	<b>453,383</b>
<b>Transaksione me pronarët e Shoqërisë</b>				
Dividendë të paguar	-	-	-	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>2,232,909</b>	<b>262,225</b>	<b>1,590,662</b>	<b>4,085,796</b>

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra individuale e flukseve monetare**  
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Shënimë	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë operative</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>557,721</b>	<b>163,883</b>
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	15	142,257	130,447
Humbje nga nxjerra jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale		-	3,512
Të ardhura nga interesi	28	(18,095)	(11,010)
Të ardhura nga dividendët	28	-	(135,792)
Zhvlerësimi të llogarive të arkëtueshme nga sigurimi	11	65,932	66,495
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>			
<b>Ndryshime në:</b>		<b>747,815</b>	<b>217,535</b>
— llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi		917,911	(1,278,264)
— llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi		63,884	(88,006)
— kostot e shtyra të marrjes në sigurim		(13,094)	(21,998)
— aktivet e tjera		(97,660)	(317,693)
— rezervat për dëme		(830,770)	1,453,600
— rezervat për primet e paftuara		(16,976)	201,732
— detyrimet dhe provizonet e tjera		(51,207)	356,119
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga veprimtaritë operative para interesit dhe tatimit</b>			
Tatimi fitimi i paguar		-	(7,008)
Interesa të arkëtuara		16,620	14,656
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë operative</b>		<b>736,523</b>	<b>530,673</b>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë investuese</b>			
Flukse dalëse nga blerje e aktiveve afatgjata materiale	15	(146,914)	(126,750)
Flukse hyrëse nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		18,790	-
Investime në depozita me afat		(608,354)	(411,202)
Divident të arkëtuar	28	-	135,792
<b>Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë investuese</b>		<b>(736,478)</b>	<b>(402,160)</b>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë financuese</b>			
Dividend të paguar		-	(140,000)
<b>Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë financuese</b>		<b>-</b>	<b>(140,000)</b>
Pakësim neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre		45	(11,487)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		84,588	96,075
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit</b>	<b>9</b>	<b>84,633</b>	<b>84,588</b>